

NJOFTIM PËR VEND PUNE

a) Pranimi në kategorinë e lartë drejtuese.

Në zbatim të ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, nenit 32 pika 1, “Pranimi i nëpunësve civil të kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.118, datë 05.03.2014, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND-së”, të ndryshuar, kreut IV dhe VIII, pika 1, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, njofton se;

Në administratën e tij ka 1 (një) vend të lirë pune, në pozicionin: “Drejtor” në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit, pranë Shërbimit të Integritetit Evropian

a) Kategoria e pagës I, klasa I-2

b) Qëllimi i pozicionit të punës

-Të sigurojë në mënyrë efektive ekspertizë juridike lidhur me çështjet e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit European për Kuvendin e Shqipërisë.

-Të organizojë drejtimin e burimeve njerëzore në varësi të tij, me qëllim ofrimin e një shërbimi me standard të lartë për anëtarët e Kuvendit dhe procesin legjislativ në tërësi.

c) Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

-Të organizojë punën në shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit.

-Të ndjekë zbatimin me cilësi dhe në kohë të detyrave të ngarkuara .

-Të përgatisë dhe koordinojë dhënien e mendimeve të specializuara juridike për komisionet e përhershme të Kuvendit, për projektligjet, aktet e tjera normative të cilat i janë paraqitur për shqyrtim dhe diskutim Kuvendit, lidhur me:

- i. përputhshmërinë e tyre me *acquis communautaire* të BE, si dhe
- ii. shkallën e përafrimit të legjislacionit të zbatuar në projektin e paraqitur;
- iii. përmirësim të përcaktimeve dhe formulimeve të propozuara (duke patur në konsideratë instrumentin ligjor komunitar me të cilin synohet përputhshmëria).

-Të propozojë tek Kryetari i Kuvendit kthimin të nismëtari të projektligjeve të depozituara në Kuvend, të cilat kanë për synim përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE, në rastet kur relacioni shpjegues që shoqëron projektligjin nuk përmban vlerësimin e harmonizimit të tij me legjislacionin e Bashkimit European. Ky propozim bëhet përpara se të projektligji të perfshihet në programin e punës dhe kalendarin e punimeve të Kuvendit.

-Të propozojë tek Kryetari i Komisionit, kthimin e projektligjit që ka për objekt përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE, kur konstaton që projektligji në brendinë e tij ka mangësi dhe probleme thelbësore me *acquis communautaire* të BE, me të cilin sipas relacionit shoqëruar është synuar përafrim i plotë apo i pjesshëm.

- Të bashkëpunojë dhe bashkërendojë punën me drejtuesit e shërbimeve/njësive të tjera të Kuvendit për çështjet e përafrimit të legjislacionit dhe vecanerisht me shërbimin juridik, shërbimin e komisioneve dhe shërbimin e kerkimit shkencor.
- Sipas orientimit dhe drejtimit të Sekretarit të Përgjithshëm, të bashkëpunojë dhe bashkërendojë punën, me drejtuesit e shërbimeve/njësive të tjera të Kuvendit për përgatitjen e raporteve lidhur me procesin e Integritetit Europian.
- Nën drejtimin dhe orientimin e Sekretarit të Përgjithshëm, të vendosë lidhje të drejtpërdrejta dhe të bashkëpunojë me Ministrinë e Integritetit dhe me njësitë e integritetit Europian në ministritë e tjera të linjës për çështje që lidhen me përafrimin e legjislacionit.
- Sipas orientimit dhe drejtimit të Sekretarit të Përgjithshëm, të mbajë lidhje me organizmat ndërkombëtarë, organet homologe të parlamenteve kombëtare të vendeve anëtare/kandidate të Bashkimit Europian lidhur me çështjet e përafrimit të legjislacionit.
- Të garantojë mbarëvajtjen e punës brenda Shërbimit që drejton për përfshirje dhe angazhim në procesin e vlerësimit parandalues të korrupsionit në legjislacion si dhe në kuadër të procesit të Kontrollit Post-Legjislativ.
- Të garantojë mbarëvajtjen e punës brenda Shërbimit që drejton për përfshirje dhe angazhim në kuadër të platformës së konsultimit publik.
- Të garantojë mbarëvajtjen e punës brenda Shërbimit që drejton për përfshirje dhe angazhim në kuadër të sistemit *E-Legis*

d) Kërkesat e përgjithshme për këtë vend pune janë;

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji.

e) Kërkesat e veçanta për këtë vend pune janë:

- Të ketë diplomë universitare DND; DIND ose Bachelor + Master profesional / shkencor, në jurisprudencë, me shkeputje nga puna;
- Të ketë kryer edhe studime pasuniversitare, Master;
- Të ketë njohuri shumë të mira dhe ekspertie mbi 5 vjet në fushën e legjislacionit shqiptar dhe të legjislacionit të Bashkimit Evropian.
- Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi, koordinimi dhe menaxhimi.
- Të zotërojë me dëshmi të paktën një gjuhë të BE
- Të ketë aftësi të punojë në grup dhe të punojë ngushtësisht me shërbimet e tjera paralele.

ë) Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi, në Shërbimin e Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve të Kuvendit (Njësia Përgjegjëse), këto dokumente: letër motivimi për aplikim në vendin vakant, një kopje të jetëshkrimit (C.V), fotokopje e diplomës, nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njësuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, fotokopje e listës së notave, nëse ka një diplomë dhe listë notash, të ndryshme me vlerësimin e njohur në shtetin shqiptar, atëherë aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar, dëshmi të njohjes së gjuhës së huaj një fotokopje e librezës së punës e plotësuar, vërtetim i gjendjes gjyqësore, certifikata të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme, fotokopje e letërnjoftimit, vendimi i statusit “nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues”, formularin e vlerësimit të gjashtëmujorit të fundit. dëshmi penaliteti, raport për gjëndjen shëndetësore.

f) Pranimi i dokumentave do të bëhet deri në datën **27.06.2025**.

g) Në datën **07.07.2025**, do të shpallet lista e vlerësimit paraprak të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në stendën e informimit të publikut. Këta do të jenë ata që plotësojnë të gjitha kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të kërkuara më sipër.

-Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 5 ditëve pune nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve pune nga data e depozitimit të saj.

gj) Në datën **28.07.2025**, do të shpallet lista e rivlerësimit dhe verifikimit të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në stendën e informimit të publikut. Këta do të jenë ata që plotësojnë të gjitha kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të kërkuara më sipër dhe ata të kualifikuar pas ankimit.

h) Konkurimi-testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet në datën **31.07.2025**, në ambjentet e Kuvendit, **në orën 10-00**.

Konkurimi do të bazohet në njohuritë për specialitetin, Kushtetutën, Ligjin “Për nëpunësin civil”, Kodin e Procedurave Administrative si dhe të legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e Kuvendit.

i) Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit, i ngritur pranë institucionit të Kuvendit të Shqipërisë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht: vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve 10 pikë që përfshin vlerësimin e arsimimit, eksperiencës dhe trajnimeve të lidhura me fushën si dhe vlerësimin e arritjeve vjetore, testimi me shkrim 40 pikë dhe intervista e strukturuar me gojë 50 pikë.

Ankesat nga kandidatët, paraqiten në KPP, brenda 5 ditëve nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të saj.

k) Shpallja e fituesit do të bëhet në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në stendën e informimit të publikut **në datën 06.08.2025**.

Për sqarime, mund të kontaktoni me numrin e telefonit +35542278270 dhe +35542278425, ose në adresën: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr.4, Tiranë.